

Njoftim për vend vakant SPECIALIST/E SHERBIM KLIENTI**Orari***Part-time***Rreth EasyPay**

Njerëzit meritojnë më shumë nga paratë e tyre – më shumë transparencë, më shumë menaxhim dhe më shumë mundësi. Që nga viti 2010, EasyPay është në një mision për të ofruar pikërisht këtë. Ne jemi platforma më gjithëpërfshirëse e pagesave dixhitale në Shqipëri, duke i ndihmuar individët dhe bizneset të paguajnë, të marrin pagesa, të shpenzojnë dhe të transferojnë para në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt.

Suksesi ynë qëndron te dy elementë thelbësorë: ekipi dhe kultura jonë. Me një ekip të përkushtuar prej mbi 55 profesionistësh jemi duke punuar që të arrijmë misionin tonë. Dhe ne jemi në kërkim të individëve të shkëlqyer që duan të krijojnë produkte financiare revolucionare dhe të ndërtojnë të ardhmen e shërbimeve financiare në Shqipëri dhe rajon.

Rreth Rolit

Në këtë rol, ju do të jeni pika e parë e kontaktit për klientët tanë, duke asistuar në pyetjet e tyre, zgjidhur çështje dhe siguruar një përvojë të shkëlqyer.

Rolet dhe Përgjegjësitë kryesore:

- Të përgjigjet në mënyrë profesionale dhe të shpejtë ndaj kërkesave të klientëve përmes telefonit, email-it dhe kanaleve të tjera të komunikimit.
- Të ofrojë informacion të saktë dhe të përditësuar mbi produktet dhe shërbimet financiare të kompanisë.
- Të ndihmojë klientët në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme financiare, duke përfshirë çështjet e llogarive, pagesave dhe shërbimeve të tjera.
- Të punojë ngushtë me departamentet e tjera të kompanisë për t'u siguruar që klientët të marrin një shërbim të plotë dhe të kënaqshëm.
- Të identifikojë mundësitë për të përmirësuar eksperiencën e klientëve dhe të përcjellë rekomandimet të menaxherit të departamentit.

Kërkesat dhe njohuritë e nevojshme

- Eksperiencë e mëparshme në shërbimin ndaj klientit.
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese, verbale dhe të shkruara.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe efektive në grup.
- Qasje të kujdesshme dhe profesionale ndaj zgjidhjes së problemeve.
- Diploma Universitare nuk është domosdoshmeri për këtë pozicion

Cfare ne ofrojme:

- Një mundësi e shkëlqyer për **zhvillim personal**. Në departamentin e marketingut dhe shërbimit të klientit, ne jemi një ekip i vogël dhe besojmë se është vendi i përsosur për t'u rritur dhe mësuar.
- Mundësi për të sjellë ide të reja në një ekip ku **nuk do të dëgjoni kurrë shprehjen " ... sepse kështu i kemi bërë gjithmonë gjërat më përpara"**
- Zyra jonë në Tiranë ndodhet direkt **në zonën e Bllokut**, shumë afër dhe e aksesueshme nga kudo.
- *Mundësi trajnimi dhe zhvillim të karrierës*
- **Team Retreats** - Të paktën dy herë në vit i gjithë ekipi ynë organizon udhëtime ekipore për t'u argëtuar dhe për të qenë të gjithë së bashku në një ambient të ndryshëm.

Personat e interesuar duhet të dërgojnë CV-në në adresën e-mail: hr@easypay.al

Të gjitha aplikimet do të trajtohen në konfidencialitet të plotë. Bazuar në ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", neni 12 -17, informacioni personal i depozituar për aplikimin për punësim do të përdoret vetëm për këtë qëllim.

Ju informojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen nga Departamenti i Burimeve Njerëzore mirëpresim!

Afati fundit për të aplikuar 28/01/2025